



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr. 2761 Prot.

Tiranë, më 01.06.2017

URDHËR

Nr. 277 datë 01.06.2017

“PËR PEZULLIMIN E LEJEVE VJETORE TË FUNKSIONARËVE, NËPUNËSVE, DHE PUNONJËSVE TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË SI DHE TË INSTITUCIONEVE TË VARTËSISË, PËR PERIUdhËN 01.06.2017 – 25.06.2017”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe VKM nr.511, datë 24.10.2002, “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Funkionarëve, nëpunësve, dhe punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe të institucioneve të vartësisë, që përfitojnë pushime vjetore të paguara, për shkak të ngarkesës në punë, t’u pezullohen lejet vjetore për periudhën 01.06.2017 – 25.06.2017.
2. Të gjithë nëpunësit, punonjësit të cilët janë duke i kryer lejet vjetore, të njoftohen për ndërprerjen e lejes vjetore dhe paraqitjen në detyrë.
3. Planifikimi dhe kryerja e lejeve vjetore të vijojë nga data 26.06.2017 e në vazhdim sipas legjislacionit në fuqi.
4. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, funksionarët, nëpunësit dhe punonjësit e Ministrisë së Shëndetësisë si dhe të institucioneve të vartësisë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
5. Moszbatimi i këtij urdhri sjell përgjegjësi disiplinore sipas legjislacionit në fuqi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ARBEN BEQIRI

MINISTËR

